



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

ZYRA E PROKURIMIT

01 NR 351-1635/23

DATE 13.01.2023

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË NR.01-2023 634-22-9062-5-2-1/C546

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;
dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik MIRUSHA COMPANY SH.P.K.; Rahovica Commerce SH.P.K., Rruga "Abedin Rexha" p.n., Klinë, me numër biznesi 810317067 (në vazhdim "Kontraktori"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike kornizë për Punët e riparimit/mirëmbajtjes si në vijim:

Furnizim me zhavor për riparim të rrugëve lokale dhe fushore për shërbime tjera për pastrim të kanaleve nga inertët të lumenjeve në rrugë dhe zona urbane me numër identifikues: 634-22-9062-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themelojë kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e punëve të riparimit/mirëmbajtjes në vijim:

Furnizim me zhavor sipas njesis kerkuse ne paramasa

Nr.	Grupi
1	Furnizim me zhavor për riparim të rrugëve lokale dhe fushore për shërbime tjera për pastrim të kanaleve nga inertët të lumenjeve në rrugë dhe zona urbane

[Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet]

[Përdorimi i kësaj kontrate publike kornizë është i detyrueshëm për të gjithë Autoritetet Kontraktuese të specifikuar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të

kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek Kontraktori, duke specifikuar listën e punëve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative . Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë punë, të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 16.01.2023 dhe përfundon me 15.01.2026

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për ekzekutimin e punëve do të jetë **me njëherë** nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë **Kline dhe fashtrat e klimes sipas kërkeses nga njesia kerkuse**

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të punëve riparuese janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Kontraktuesi.

Vlera totale indikative e kontratës është **299,500.00** Euro. Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është plus(+), minus (-) 30% e vlerësse kontratës.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë..

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *Sigurimi i ekzekutimit*

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet


5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqimi, miratimi, certifikata apo vendimi do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët shqipe¹ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues Komuna Kline

Emri:	Labinot Morina
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	13.01.2023
Vula:	

Për Kontraktorin Mirusha Company

Emri:	Dardan Desku
Pozita:	Person i autorizuar
Nënshkrimi:	
Data:	13.01.2023
Vula:	

¹ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

FURNIZIM ME ZHAVOR PER RIPARIM TE RRUGEVE LOKALE DHE FUSHORE PËR SHERBIME TJERA PER PASTRIM TË KANALEVE NGA INERTET NË LUMENJE DHE RRUGE DHE ZONA URBANE

Nr.	Titulli	Çmimi për njësi (me TVSh)	Sasia	Njësia matëse	Totali (me TVSh)	Shënim autoriteti kontraktues
1	Furnizimi, transporti, rrafshimi i paraprak i rrugës sipas nevoje dhe shpërndarja me grejder, dhe ngjeshja me cilindër e zhavorrit gurë i thyer - me fraksion Ø = 0-0.31mm	11.00	15,000.00	M3	165,000.00	FURNIZIM . TRANSPORT DHE RRAFSHIM ME NGJESHJE
2	Furnizimi, transporti, rrafshimi i paraprak i rrugës sipas nevoje dhe shpërndarja me grejder, dhe ngjeshja me cilindër e zhavorrit gurë i thyer - me fraksion Ø = 0-0.61mm	10.40	10,000.00	M3	104,000.00	FURNIZIM . TRANSPORT DHE RRAFSHIM ME NGJESHJE
3	Furnizimi, transporti, vendosja ne vendet e rrezikuara nga erozioni dhe shembja e dheut ne rruge apo brigje te lumenjve dhe ngjeshja me cilindër sipas nevoje e zhavorrit gurë i minuar - me fraksion Ø = 0.61-1000mm	8.00	500.00	M3	4,000.00	FURNIZIM . TRANSPORT DHE RRAFSHIM ME NGJESHJE
4	Punë me ekskavator tonazhi i mesëm mbi 24ton , dhe grejder sipas nevojave dhe kërkesave ne teren. Gërmimi i dheut, hapje dhe pastrim i kanaleve anësore te rrugëve , pastrim i terrenit dhe inerteve ne afërsi te lumenjve, proçkave dhe vendbanimeve etj	60.00	300.00	ORE PUNE	18,000.00	ME MAKINERI TE NEVOJESHME
5	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave te betonit Ø 400mm	35.00	50.00	m'	1,750.00	
6	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave te betonit Ø 600mm	40.00	50.00	m'	2,000.00	
7	Furnizimi dhe vendosja e kapakeve të pusetav , nga materiali i gizes me aftesi mbajtese 40t per mos depertimin e ujerave atmosferike ne pusete. Sipas detali te prezentuar ne projekt.	90.00	25.00	copë	2,250.00	
8	Ngarkimi dhe bartja deri ne vendin e caktuar nga Autoritetit Kontraktues e materialeve inerte, dheut, mbeturina te përziera apo materiale tjera sipas nevojës dhe kërkesës, si dhe rrafshimi rregullimi i terrenit pas heqjes se mbeturinave	2.50	1,000.00	M3	2,500.00	
TOTAL					299,500.00	

